



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:225289
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05745023

K.DH.Shk II.nr. 755/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “Pallati i Rinisë SH.A., me nr. unik identifikues 810962052 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Luan Haradinaj” që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Korab Rexhepi me zyre në Prishtinë, kundër debitorit Institucioni Privat Arsimor “American School of Kosova” SH.P.K., me nr. unik identifikues 810502593, me seli në Obiliq-Shkabaj, rr. “Remzi Hoxha” nr.1, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Agnez Furra me zyre në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.469/22 të datës 26.01.2023, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Institucioni Privat Arsimor “American School of Kosova” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 469/22 të datës 26.01.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 469/22 të datës 26.01.2023, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit Institucioni Privat Arsimor “American School of Kosova” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 120/20, i lejuar me datë 19.03.2020, nga Përmbartuesi Privat Ilir Mullhaxha dhe Urdhri

Përmbarrimor P.nr. 120/20, i lejuar me datë 19.03.2020, nga Përmbarruesi Privat Ilir Mullhaxha mbetet në fuqi

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarrimore, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 469/22 të datës 26.01.2023

Kreditore nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditore Pallati i Rinisë SH.A., ka paraqitur propozim për përmbarrim P.nr. 120/20i lejuar me datë 19.03.2020, me të cilin ka lejuar përmbarrimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; faturë nr. 2/2017 për muajin tetor 2017; faturë nr. 3/2017 për muajin nëntor 2017; 3. faturë nr. 4/2017 për muajin dhjetor 2017; 4. faturë nr. 5/2018 për muajin janar 2018; 5. faturë nr. 6/2018 për muajin shkurt 2018; 6. faturë nr. 7/2018 për muajin mars 2018; 7. faturë nr. 8/2018 për muajin prill 2018; 8. faturë nr. 9/2018 për muajin maj 2018; 9. faturë nr. 10/2018 për muajin qershor 2018; 10. faturë nr. 11/2018 për muajin korrik 2018; 11. faturë nr. 46891 për muajin gusht 2018; 12. faturë nr. 47827 për muajin shtator 2018; 13. faturë nr. 091-10/18-119A për muajin tetor 2018; 14. faturë nr. 091-11/18-119A për muajin nëntor 2018; 15. faturë nr. 091- 12/18-119A për muajin dhjetor 2018; 16. faturë nr. 091-01/19-119A për muajin janar 2019; 17. faturë nr. 091-02/19-119A për muajin shkurt 2019; faturë nr. 26/2018 për muajin qershor 2018; faturë nr. 27/2018 për muajin korrik 2018; faturë nr. 46864 për muajin gusht 2018; faturë nr. 47750 për muajin shtator 2018; faturë nr. 090-10/18-119 për muajin tetor 2018; faturë nr. 090-11/18-119 për muajin nëntor 2018; faturë nr. 090-12/18-119 për muajin dhjetor 2018; faturë nr. 090-01/19-119 për muajin janar 2019; faturë nr. 090-02/19-119 për muajin shkurt 2019 dhe faturë nr. 090-03/109-119 për muajin mars 2019, ashtu që është

urdhëruar debitori që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekura, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme në vlerë prej 113,900.32 EUR (me shkronja: njëqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind euro e tridhjetë e dy euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita kur secila faturë është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto nga dita e pranimit të urdhrin për përmbarim.

Debitori me datë 26.05.2020 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarimit duke shtuar se debitori nuk e konteston borxhin që ka ndaj kreditorit sa i përket faturave të lëshuara përgjatë kontratës dhe aneks kontratës së qirasë të lidhur me kreditorin, por konteston borxhin e faturuar pas kalimit të afatit kontraktues, pasi që pas kalimit të afateve, debitori nuk e ka shfrytëzuar këto hapësira, kjo sepse debitori që nga data 01.10.2018 është larguar nga hapësirat e kreditorit dhe është bartur në një objekt krejt tjetër shkollor. Me kërkesë që të mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit për faturat që janë lëshuar deri më datë 31.08.2018 ndërsa të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit për faturat e lëshuara pas kësaj date, ndërsa kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori me arsyetimin se të gjitha faturat objekt i këtij përmbarimi janë të nënshkuara nga ana e debitorit, dhe me vet faktin se debitori është deklaruar se lokalit e ka shfrytëzuar deri më datë 01.10.2019 rezulton se nuk ka asgjë kontestuese, pasi që të gjitha faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi janë lëshuar brenda këtyre afateve. Tutje ka sqaruar se nga korrespondenca mes kreditorit dhe debitorit vërtetohet se debitori jo vetëm që e ka shfrytëzuar hapësirën kontestuese, por të njëjtën e ka dhënë me nën-qira tek personat e tretë. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbarimit të detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-

së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Tutje Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat vlerëson se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbaerimor P.nr. 120/20 i datës 19.03.2020 i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbaerimor nga përmbaeruesi privat P.nr. 120/20 i datës 19.03.2020 duke u bazuar në dokument të besueshëm të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Dhe rrjedhimisht në rastin konkret faturat e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbaerimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që është dorëzuar në origjinal, mban vulën e pranimit të debitorit, si dhe nuk është kontestuar nga debitori.

Tutje shkalla e parë ka vlerësuar pretendimet e debitorit se në rastin konkret kontratat mbi shfrytëzimin e hapësirave afariste të kreditorit kanë skaduar me datë 01.07.2018, respektivisht me datë 31.08.2018, andaj të gjitha faturat e lëshuara pas këtyre datave janë të papërshtatshme për përmbaerim, por që në rastin konkret, gjykata është kufizuar vetëm në vlerësimin e elementeve formale të faturave që i janë bashkëngjitur propozimit për përmbaerim, e të cilat si dokumente të besueshme, paraqesin bazë për lejimin e përmbaerimit dhe rezultojnë të jenë të përshtatshme për përmbaerim meqenëse i përmbajnë të gjitha elementet nga neni 29, par.3 i LPP-së.

Dhe duke u bazuar në të lartcekurat, shkalla e parë lidhur me këtë çështje përmbaerimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaerimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në

kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative qe duhet t'i ketë dokumentin e besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat me nr. 2/2017 për muajin tetor 2017; faturë nr. 3/2017 për muajin nëntor 2017; 3. faturë nr. 4/2017 për muajin dhjetor 2017; 4. faturë nr. 5/2018 për muajin janar 2018; 5. faturë nr. 6/2018 për muajin shkurt 2018; 6. faturë nr. 7/2018 për muajin mars 2018; 7. faturë nr. 8/2018 për muajin prill 2018; 8. faturë nr. 9/2018 për muajin maj 2018; 9. faturë nr. 10/2018 për muajin qershor 2018; 10. faturë nr. 11/2018 për muajin korrik 2018; 11. faturë nr. 46891 për muajin gusht 2018; 12. faturë nr. 47827 për muajin shtator 2018; 13. faturë nr. 091-10/18-119A për muajin tetor 2018; 14. faturë nr. 091-11/18-119A për muajin nëntor 2018; 15. faturë nr. 091- 12/18-119A për muajin dhjetor 2018; 16. faturë nr. 091-01/19-119A për muajin janar 2019; 17. faturë nr. 091-02/19-

119A për muajin shkurt 2019; faturë nr. 26/2018 për muajin qershor 2018; faturë nr. 27/2018 për muajin korrik 2018; faturë nr. 46864 për muajin gusht 2018; faturë nr. 47750 për muajin shtator 2018; faturë nr. 090-10/18-119 për muajin tetor 2018; faturë nr. 090-11/18-119 për muajin nëntor 2018; faturë nr. 090-12/18-119 për muajin dhjetor 2018; faturë nr. 090-01/19-119 për muajin janar 2019; faturë nr. 090-02/19-119 për muajin shkurt 2019 dhe faturë nr. 090-03/109-119 për muajin mars 2019, e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbareshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbaresh sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbaresh duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbaresh të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbaresh organi përmbaresh, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbareshit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbaresh, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbaresh dhe/apo atij të besueshëm, me ç' rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaresh.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 755/24 me datë 28.05.2024

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti**